

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

**Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve
ID 7.12/j “Veshje e telave spirale”**

**Prodhimi i produkteve plastike
7.13 “Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të
kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike”**

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: “Maccaferri Balkans” SH.P.K.

NIPT: K92326003C

**VENDNDODHJA: Durrës, Xhafzotaj, Autostrada Durrës -Tiranë, km 6,
Xhafzotaj Shijak.**

1. PROFILI I KOMPANISE

Maccaferri Balkans Sh.p.k. është anetare e Grupit Industrial Maccaferri, një kompani që prodhon, eksporton dhe inporton produkte me marka të regjistruara të grupit industrial “Maccaferri” i cili është lider botëror në fushën e Gjeoteknikës. Selia kryesore e Maccaferri Group është në Bolonjë të Italisë, dhe me filiale në pesë kontinente dhe me mbi 2.000 punonjës. Sfida kryesore për Maccaferri është që të lëvizë drejt një arenë të gjerë inxhinierike, për të ndjekur një integrim vertikal dhe përfshirje në çdo fazë të procesit, nga projektimi të furnizimit me materiale dhe instalimi i tyre. Qëllimi kryesor është që të bëhet ofruesi kryesor ndërkombëtar për zgjidhje të avancuara në inxhinierinë civile dhe të ndërtimit të tregut. Fabrika Maccaferri Balkans ka një teknologji prodhimi bashkohore të viteve 2000 dhe produktet e saj janë të certifikuar CE & ISO 9001.

Kompania Maccaferri Balkans shpk ofron një gamë të gjërë materialesh me baze metalike për infrastrukturen rrugore si:

- *Gabiona* (GABBION) të gjitha dimensionet me gjatësi nga 1÷3 m dhe me lartësi 0.5m & 1m.
- *Materase Reno* për aplikime në veshjet lumore, gjatësi 3÷6 m, gjeresi 2m dhe lartësi 0.17m/0.23m/0.3m.
- *Gabiona në formë thesi* për mbrojtjen e brigjeve lumore nga erozioni.
- *Terramesh* (produkt i strukturave me toke të forcuara).
- Rock Fall System.

Kompania importon dhe eksporton materiale që përdoren në fushën e gjeoteknikës siç janë:

- Gjeogride
- Gjeotekstile me peshë që variojnë 65-500gr/m².
- Materiale për mbrojtjen e skarpatave:
- Material për mbrojtje ndaj erozionit të skarpatave (MACMAT),
- Materiale drenazhues (MACDRAIN dhe tuba drenazhi);
- Fibra Celiku për realizimin e dyshemeve të mëdha industriale prej betoni të armuar dhe pareteve të tuneleve. MB ofron zgjidhje të reja, të qendrueshme dhe ekonomike nëpërmjet projekteve të sajë “Turn Key” projektim-furnizim-zbatim-certifikim, në këtë mënyrë kompania pretendon të jetë partnere dhe jo thjesht shitës materialesh për klientet e saj.

Subjekti do të aplikojë për leje mjedisi Tip B

Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve

ID 7.12/j “Veshje e telave spirale”

Prodhimi i produkteve plastike

7.13 “Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike”

Referuar shtojcës 1 të ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

2. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

2.1. Subjekti Investitor

Subjekti “Maccaferri Balkans” Sh.p.k. me numer NIPT K92326003C me administrator **Giovanni Francia**, i regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me datë **26/11/2009** dhe vendndodhje **Durrës, Xhafzotaj, Autostrada Durrës -Tiranë, km 6, Xhafzotaj Shijak**.

2.2. Qellimi i aktivitetit

Qellimi i këtij aktiviteti është të ushtroje veprimtarinë sipas pershkrimit: **ID 7.12/j “Veshje e telave spirale”** dhe **ID 7.13 “Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike”**

Ky subjekt ka si qëllim të sigurojë vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis si dhe të ushtroje veprimtarinë e tij në përputhje me të gjitha parametrat mjedisore për mos të shkaktuar asnjë ndotje ose dëmim të mjedisit.

2.3. Objektivat e aktivitetit:

1. Objektivi i parë i këtij aktiviteti do të jetë të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore këtij instalime të cilat janë:
 - Emetimet në ajër dhe zhurmat;
 - Ndikimi në flore/faunë;
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
 - Ndikime social-ekonomike;
 - Ndikim në cilësinë e jetes në qendrat e banuara;
 - Ndikim në rritjen e trafikut rrugor;
 - Ndikim në peizazhin e zonës;
2. Objektivi i dytë i këtij aktiviteti është gjetja e alternativave që janë me miqësore me mjedisin.

2.4. Vendndodhja e aktivitetit

Vendndodhja ku pritet të zhvillohet aktiviteti është në adresën: **Durrës, Xhafzotaj, Autostrada Durrës -Tiranë, km 6, Xhafzotaj Shijak**.

Zona e cila përdoret për funksionimin e aktivitetit është e rehabilituar, e shtruar me beton. Aktiviteti operon prej shumë vitesh, pa krijuar shqetësime për banorët, njesitë e biznesit të ndodhur aty pranë. Territori është i rrethuar me mur dhe i pajisur me porte hyrese duke mos prishur kështu pamjen vizuale të zonës. Trualli në të cilin ndodhet objekti shtrihet në një terren të rrafshët dhe prona është e karakterizuar nga një sipërfaqe uniforme, ku efekti i erozionit nuk

është i ndjeshëm. Permiresimi urban i zones, ka patur zhvillime mjaft të shpejta duke terhequr interesin e zhvillimeve të reja të biznesit, gjithashtu edhe të zhvillimit të metejshëm të njesive urbane.

2.5. Proceset e punës dhe produktet

Aktiviteti për të cilin subjekti “Maccaferri Balkans” SH.P.K. do të pajiset me leje mjedisore tipi B është “Veshje dhe thurjen e telave”.

Për ushtrimin e aktivitetit prodhues shoqëria zotëron Fabriken e Prodhimit dhe Makineritë e Linjave të Prodhimit, të përbëra nga:

- dy linja prodhimi të teknologjise 8x10,
- një linje prodhimi 6x8 dhe
- një makineri për veshjen e telit me material të plastifikuar.

Për prodhimin e materiale gjeoteknike, si gabiona, rrjeta me përdredhje të dyfishtë, lënda e pare që përdoret është teli i dimensioneve të ndryshme me bazë celiku.

Meqëse aktiviteti tregtar është i përqëndruar rreth 85% për eksport dhe 15% për shitjet lokale në RSH, shoqëria është e pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me autorizime për regjimin për punim aktiv, Nr.RPA AL 3851/1 datë 13.09.2021.

Kompania “Maccaferri Balkans” Sh.p.k. ofron një gamë të gjërë materialesh me baze metalike për infrastrukturen rrugore si:

1. *FlexMac® DT-* (Rrjete teli dhe shufra celiku për mbrojtjen nga vershimet) vendoset si një barrierë për mbrojtjen ndaj përmytjeve, ngritjen e argjinaturave dhe sigurojnë mbështetje për punime të përkohshme.



Konsiston në një strukturë më shumë ndarje e përbërë nga rrjetë teli gjashtëkëndore dopio e përdredhur. Rrjeta është përforcuar me shufra çeliku vertikale dhe të veshura me një mbështjellje gjeotekstili jo të endur. Struktura me ndarje mbushet në vend me material mbushës të vendit për të siguruar një sistem barrierash kundër ngritjes së nivelit të ujit, apo të gërmimeve në punime të përhershme. Njësitë FLEXMAC® DT bashkohen në gjatësi duke përdorur kunjat bashkuese për të krijuar një strukturë në gjatësinë e kërkuar. Rrjeta e telit gjashtëkëndore e përdredhur dyfish është projektuar për të siguruar rezistencë përmes fleksibilitetit. Kjo i jep strukturës fleksibilitet më të lartë se sa zgjidhjet më rigjide dhe është ideale në zonat ku ndodhin ulje diferenciale.

2. *Gabionet*- përbëhen nga tela çeliku të cilësisë së lartë, që është gjithmonë i galvanizuar për të siguruar një mbrojtje afatgjatë ndaj korrozionit. Një veshje mbrojtëse shtesë polimeri aplikohet gjithashtu për gabionet që përdoren në kushte më agresive të mjedisit, ose kur kërkohet një jetëgjatësi më e madhe.



Për përforcimin e strukturës, të gjitha cepat e panelit me rrjetë kapen me një tel me një diametër më të madh. Veshja polimere PA6 i është shtuar gamës së veshjeve mbrojtëse për të ofruar zgjidhje atyre projekteve që kërkojnë një mjedis të përmirësuar dhe performancë teknike në krahasim me rrjetat e veshura me PVC dhe HDPE që janë në treg.

3. *Gabionët Sack* - janë kosha cilindrike të projektuar nga rrjeta teli çeliku të endura në një formë gjashtëkëndore dhe të përdredhur dyfish.



Njësitë cilindrike mbushen me gurë në terren dhe lidhen fort. Kjo njësi modulare përdoret pastaj për të siguruar mbrojtje

ndat erozionit për brigjet lumore, mbrojtje ndaj gërryerjeve të këmbës së urës, ose në çdo situatë që kërkon mbrojtje të menjëhershme nga efektet e erozionit të ujit. Gabionët thasë ngarkohen në vendodhje duke përdorur pajisje të përshtatshme dhe grumbullohen njëri mbi tjetrin për të formuar një masë mbajtëse shkëmbore.

Rrjeta përbëhet nga tela çeliku të cilësisë së lartë, që është gjithmonë e galvanizuar për të siguruar një mbrojtje afatgjatë ndaj korrozionit. Një veshje mbrojtëse shtesë polimeri aplikohet gjithashtu për gabionet që përdoren në kushte më agresive të mjedisit, ose kur kërkohet një jetëgjatësi më e madhe.

Gabionët thasë furnizohen bashkë me tela përforcues çeliku të vendosura gjatë procesit të prodhimit për të thjeshtuar mbylljen e tyre gjatë instalimit. Për përforcimin e strukturës, të gjitha cepat e panelit me rrjetë kapen me një tel me një diametër më të madh.

4. *Steelgrid®* - është një gjeokompozitë çeliku me rezistencë të lartë, ngurtësi të lartë që kombinon fleksibilitetin dhe përfitimet praktike të rrjetës dopio të përdredhur me ngurtësi e pritshme dhe qëndrueshmërinë mekanike të kabllave



prej çeliku me rezistencë të lartë në tërheqje. Kabllot prej çeliku janë të endur në rrjetën e përdredhur dyfish gjatë prodhimit, duke formuar një produkt që mund të instalohet vetëm dhe thjeshtë.

Punë të kryera



3. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

Shkarkime ne ajer – Gjenerime ne ajer nga operatori do te jene gjenerimi minimale te monitorueshme dhe brenda vlerave kufi. Gjithashtu ne kete grup gjenerimesh do te konsiderojme edhe mjetet te cilat depozitojne lenden e pare per perpunim apo produktin perfundimtar.

Shkarkime ne ujera – Zhvillimi I aktivitetit nuk shoqerohet me shkarkime me karakteristika ndotese ne ujerat siperfaqesore, ashtu edhe ato nentokesore. Do te kemi shkarkime ne kanalizime te ujerave higjieno-sanitare, te cilet nuk mbartin komponente ndotes.

Duke qene se gjate zhvillimit te proceseve qe do te kryeje subjekti nuk do te perdoret uje, atehere nuk kemi gjenerim te ujerave teknologjike.

Shkarkime ne toke - Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk do te kemi shkarkime ne toke. Mbetjet nga ky aktivitet do te evadohen ne menyren me te mire te mundshme.

Zhurma dhe vibrime – Zona ne te cilen zvillohet aktiviteti eshte nje zone e populluar, kryesisht industrial. Per kete arsye zhurma eshte prezente ne cdo ore te dites, si nga qarkullimi rrugor I makinave, ashtu edhe nga aktiviteti njerezor. Nga funksionimi I aktivitetit nuk pritet te kete rritje te nivelit te zhurmave. Te vetmet zhurma qe mund te gjenerohen jane nga mjetet te cilet sjellin lenden e pare ne subjekt si dhe nga proceset e punes te cilat vlen te theksohet se kryhen ne mjediset e brendshme te fabrikes.

Vibrime ne nivele minimale mund te konsiderojme ato te cilat shkaktohen nga levizja e mjeteve te renda qe sjellin lenden e pare ne ambjetet e kompanise.

Mbetje – Ky lloj aktiviteti gjeneron 2 tiplogji mbetjesh te cilat jane:

- **Mbetje nga aktiviteti I punonjesve-** per te cilat subjekti do te vendose kosha me ngjyra, me qellim diferencimin e tyre qe ne gjeneze. Pas cdo dite pune keto mbetje do te depozitohen per ne kontenieret e perbashket te vendosur nga Pushteti Vendor.
- **Mbetje nga proceset e punes-** mbetje te tilla si mbetje telash, plastike etj. do te rifuten ne process nese eshte e mundur ose operatorit do t’I rekomandohet te lidhe kontrate me subjekt te licensuar per trajtim e metejshem te tyre

Ndikime ne flore dhe faune - Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores dhe faunes. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negativ ne flore apo faune.

Ndikimet e aktivitetit ne rruget lokale dhe transportin - Infrastruktura ne te gjithë perimetrin e aktivitetit eshte e shtruar, gjithashtu edhe rruga kryesore qe kalon prane aktivitetit. Nuk pritet te kete ndikime negative apo ndryshime te infrastruktures.

Ndikimet e aktivitetit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike de zonat e mbrojtura - Aktiviteti qe ushtron shoqeria do te zbatohet ne nje zone ne siperfaqen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon qe zona eshte zone e lire per te ustruar kete aktivitet dhe shume te tjere.

Ndikim social-ekonomik - Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e qytetit ku zhvillohet aktiviteti. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

4. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT K92326003C

Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

4.1 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

OPERACIONI	NDIKIME NE TOKE
Instalimi	Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem.
Lëvizja e automjeteve të transportit	Si pasojë e lëvizjes së mjeteve: - mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.

OPERACIONI	NDIKIME NE UJE
Instalimi	Shkarkimet ne ujera vijne nga: - Ujerat e perdorur per ambjentet higjeno-sanitare te ambjentit te stafit
Lëvizja e automjeteve	Si pasojë e qarkullimit të mjeteve dhe përdorimit të mekanikës mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari e mundshme me pasojë ndotje të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

OPERACIONI	NDIKIME NE BIODIVERSITET
Instalimi	Instalimi nuk parashikon ndryshime ne peisazh pasi operon ne nje zone te lokalizuar (godine), edhe ndikimin e kemi te lokalizuar.

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Shkarkim i lendes se pare	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen: - zhurma,

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT K92326003C

	<ul style="list-style-type: none">- pluhra- gaze nga djegia e karburantit të motorëve.
--	---

5. MASAT E PROPOZUARA PER ULJEN E NDIKIMEVE ME MJEDIS

Toka	
Perdorimi i tokes	<ul style="list-style-type: none">➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve➤ Mirmbajtja dhe gjelberimi i siperfaqes
Biodiversiteti	
Vegjetacioni	<ul style="list-style-type: none">➤ Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit ne zonen rrethuese.➤ Mbrojtja e bimeve ne menyre sa me te mire te mundshme rreth aktivitetit.
Cilesia e Ajrit	
Emetime ne ajer	<ul style="list-style-type: none">➤ Mbjajtja fikur e automjeteve gjate ngarkim shkarkimit te lendeve te para ne ambjentet e instalimit.
Mbetjet	
Mbetjet urbane	<ul style="list-style-type: none">➤ Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore.
Mbetje nga procesi i punes	<ul style="list-style-type: none">➤ Magazinimi i tyre ne nje vend te percaktuar nga drejtuesi i punimeve, deri ne momentin qe ato terhiqen nga operatore te licensuar ose rifutja e tyre ne proceset e prodhimit nese eshte e mundur.
Zhurmat	
Niveli i zhurmave	<ul style="list-style-type: none">➤ Respektimi I gjitha rregulloreve gjate procesit te punes.➤ Respektimi i orarit te punes➤ Levizje e ngadalte dhe e kujdesshme ne ambjente te aktivitetit.➤ Vendosja e tabelave zbatimin e rregullores ne ambjentet e aktivitetit ne menyre rigoroze.
Trafiku rrugor	
Trafiku rrugor	<ul style="list-style-type: none">➤ Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.
Fluksi i qarkullimit	<ul style="list-style-type: none">➤ Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

“Maccaferri Balkans” SH.P.K.

Administrator
Robert Masha